

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"TRAVEL & RENT CAR" Sh.p.k.

Sot, më date **22.04.2024**, ne te nenshkruarit:

-Roberta Mjeshtri lindur ne Berat me 10/07/1994,shtetas shqiptar,rezident ne Tirane,Njesia Administrative Nr.6,Rruga Tom Plezha Nr.19 , identifikuar me karten e identitetit me Nr. 037011089,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kam vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "**TRAVEL & RENT CAR**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: "**TRAVEL & RENT CAR**" Sh.p.k

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:- Yzberisht,Rruga Tom Plezha NR.19, me ZK.3866 dhe nr.pasurie 300/60.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *bertamjeshtri@gmail.com*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë per nje afat te pacaktuar,perveç zgjatjes ose prishjes se mepareshme te saj sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Agjensi udhëtimi,makina me qera,Ria,pagesa te ndryshme ,etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **1 000 000** (njemilion) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:





1. Ortaku themelues **Roberta Mjeshtri**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 1 000 000 leke që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes; (me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjrisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjrisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfshirimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarres përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi





Aministrator i shoqerise emerohet Znj.**Roberta Mjeshtri** lindur ne Berat me 10/07/1994,shtetas shqiptar,rezident ne Tirane,Njesia Administrative Nr.6,Rruga Tom Plezha Nr.19 , identifikuar me karten e identitetit me Nr. 037011089, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjesitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 3 kopje origjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

Roberta Mjeshtri

